



Titulli i projektit

Ngritja e një qendre shërbimesh me një ndalesë – Faza I “Vlerësimi i Nevojave dhe Analiza e Bistakëve”

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik/Kohezion Social

Vendndodhja e projektit

Rrashbull

Buxheti i paravlerësuar

14,000 Euro

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Njësia administrative Rashbull ka numrin më të lartë të njësive ekonomike të regjistruara në territorin e saj (pas Durrësit). Në këtë situatë, është evidentuar nevoja e ngritjes së një infrastrukture mbështetëse të nevojshme për shërbimet ndaj biznesit, konkretisht një qendre shërbimesh me një ndalesë për biznesin. Si fillim mund të ofroreshin të gjitha shërbimet e nevojshme për biznesin që ofrohen nga pushteti vendor (mundësisht dhe nga ai qendror).

Qëllimi/et specifik të projektit

Qëllimi i projektit është vlerësimi i nevojave për përmirësimin i nivelit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve mbështetëse për bizneset e vendosura në zonë. Po ashtu synohet rritja dhe përmirësimi i proceseve teknologjike me synim zhvillimin e tyre drejt fazave me vlerë të shtuar të lartë.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

Rezultatet e pritshme përfshijnë përgatitjen e një analize të thelluar mbi profilin e shërbimeve biznesore që ndërmarrjet me material porosites, të vendosura në Bashkinë e re Durrës kanë nevojë. Qëllimi final është rritja e numrit të shërbimeve të ofruara bizneseve dhe përmirësimi i nivelit të tyre.

Krijimi i qendrës së shërbimeve me një ndalesë do të ndikojë direkt në përmirësimin e nivelit të shërbimeve që do u ofrohen bizneseve aktive në Rashbull dhe 6652 banorëve të kësaj zone. Një ndikim anësor do të ketë dhe në të punësuarit e shumë të punojnë pranë bizneseve me mall porosites.



Aktivitetet e projektit

Kohëzgjatja e përafërt për zbatimin e projektit është 12 muaj.

Aktivitetet e parashikuara përfshijnë:

- a) identifikimi i të gjithë ndërmarrjeve me material porosites;
- b) ndërtimi i metodologjisë / taksonomisë së nevojave;
- c) vlerësimi i nevojave dhe planifikimi i ndërhyrjes;
- d) përgatitja e raportit final,
- e) promovimi dhe marrëdhëniet me publikun

Maturimi i projektit

Aktualisht nevojitet kryerja e një studimi fizibiliteti për bistakët (cluster) industrialë në zonën e Bashkisë së re Durrës. Kjo do të nxjerrë në pah nevojat për aftësi teknike dhe konsulencë që do kenë njësitë prodhuese në këtë zonë. Mbi këtë bazë do të ndërtohet qendra me një ndalesë.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimi kryesor është dldp. Burime të tjera të mundshme financimi janë fondet publike të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, fonde të donatorëve, si UNDP, USAID, etj..

Partnerët e mundshëm në zbatimin e këtij projekti përfshijnë ministrinë e sipërpërmendura, Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, etj..

Kostot e projektit

Kostot e projektit vlerësohen të jenë rreth 14,000 Euro.